



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:040344

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05644485

KE.nr.61/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen juridike të paditësit Shpejtimiti SH.P.K., me NUI: 811302413, me seli në rr. “Brigada 123”, në Suharekë, të cilin me autorizim e përfaqëson Florin Lata, avokat nga Prishtina, ndaj të paditurit “Shpejtimi Reisen”, me NUI: 811850420, me seli në rr. “Hajdin Berisha”, p.n., në Suharekë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Burim Halili avokat nga Prishtina, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik me datë 23.04.2024, në prani të përfaqësuesit të palës paditëse dhe përfaqësuesit të palës së paditur, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit Shpejtimiti SH.P.K., me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se i padituri “Shpejtimi Reisen”, ka shkelur markën tregtare të paditësit me numër të regjistrimit 26217, të datës 23.05.2019; të i ndalohet të paditurit që të përsërisë shkeljet e tilla ose të ngjashme ashtu që i padituri mos të përdor markën tregtare me nr. regjistrimi 26217 të datës 23.05.2019 si emër tregtar, në marketing për biznesin e tij apo në çfarëdo mënyrë tjetër të ngjashme, si dhe të ndryshoj në ARBK emrin tregtar ashtu që emri i ri të mos përmbaj fjalën “Shpejtimi”.
- II. Shpenzimet e procedurës i bartë secila palë veç e veç.

## A r s y e t i m

Paditësi Shpejtimiti SH.P.K., pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, me datën 18.01.2022, ka parashtruar padi për shkelje të markës tregtare ndaj të paditurës “Shpejtimi Reisen”. Me datën 26.03.2024, paditësi ka bërë precizimin e kërkesëpadisë, duke kërkuar që të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditësit dhe të vërtetohet se i padituri ka shkelur markën tregtare të paditësit me numër të regjistrimit 26217 të datës 23.05.2019, si dhe të i ndalohej të paditurit që të përsërisë shkeljet e tilla ose të ngjashme dhe të mos përdor markën tregtare me nr. regj 26217 të datës 23.05.2019 si emër tregtar, në marketing për biznesen e tij, apo në çfarëdo mënyrë tjetër të ngjajshme, si dhe të ndryshoj në ARBK emrin tregtar ashtu që emri i ri të mos përmbaj fjalën “Shpejtimi”, duke i kërkuar edhe shpenzimet e procedurës kontestimore.

Në referatin e padisë, ka theksuar që paditësi ka të mbrojtur markën tregtare Shpejtimi me nr. regjistrimi 26217, ku përfshihet edhe klasa 39 – transporti, ndërsa palët ndërgjyqëse operojnë në fushën e transportit të udhëtarëve, me përdorimin e emrit “Shpejtimi Reisen”. Ka theksuar që i padituri është duke shkelur markën tregtare me qëllim dhe vetëdije të plotë, pasiqë me rastin e ndarjes së bashkësisë familjare, Kompania “Shpejtimiti” SH.P.K., i është ndarë në pronësi paditësit, ndërsa i padituri ka marrë kompaninë tjetër të quajtur ER Lines, duke deklaruar që bartës i markës tregtare “Shpejtimi” është vetëm paditësi dhe se asnjëri nga familjarët e tjerë nuk ka të drejtë që ta përdor markën e mbrojtur e cila ka vlerë përmbi 200,000.00 €.

Më tutje ka theksuar që përdorimi i fjalës Reisen e cila i është shtuar markës Shpejtimi, nuk e bënë markën apo emrin tregtar të ketë identitet të veçante pasi fjala Reisen paraqet term të zakonshëm për transport dhe agjencione turistike në Kosovë, fjalë të cilën e përdorin rreth 160 biznese në ARBK, duke shtuar që marka “Shpejtimi” është markë e mirënjohur në Republikën e Kosovës dhe keqpërdorimi i saj është duke i shkaktuar probleme serioze paditësit duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me një biznes mjaft të ndishëm siç është transporti i udhëtarëve.

Gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kërkesëpadisë së precizuar, duke deklaruar që i padituri tenton që të shpërqendroj vëmendjen tek një markë figurative e cila është markë e kombinuar, e për të cilën markë është iniciuar procedura pranë API-së dhe se e njëjta nuk është objekt shqyrtimi në këtë procedurë gjyqësore, pasi që dihet se në ARBK nuk mund të regjistrohen emrat si figurë.

Ndërsa sa i përket termit “Reisen”, ka theksuar që i njëjti është term gjenerik ku nga një kërkim në ARBK rezulton se 160 biznese tjera e përdorin si formë të identifikimit të agjencioneve turistike apo kompanive transportuese. Ka shtuar që nga vendimi për regjistrimin e markës tregtare vërtetohet se paditësi ka regjistruar markën “SHPEJTIMI”, të cilin e ka edhe si emër tregtar të regjistruar në ARBK, ndërsa nga të dhënat e regjistrimit të të paditurit vërtetohet se i njëjti përmes regjistrimit në ARBK të termit “Shpejtimi Reisen”, ka përdorur pa autorizim markën e mbrojtur, edhe pse sipas LMT-së, parashihet që pronari i markës mund të ua ndaloj palëve të treta përdorimin e markës si emër tregtar të subjektit ekonomik apo pjesë të emrit tregtar, siç përcaktohet me nenin 9 par. 3, pika 4.

Më tutje ka theksuar që edhe sipas Ligjit për Shoqëritë Tregtare, me nenin 29 është përcaktuar se emri zyrtar apo emri tregtar i Shoqërive Tregtare të regjistruara nga ARBK-ja, sipas këtij ligji i nënshtrohen markave tregtare të regjistruara sipas ligjit në fuqi për marka tregtare. Në fund ka theksuar që në krahasimin e dy markave fjalë “Shpejtimi” dhe “Shpejtimi Reisen” duhet të merret parasysh konsumatori mesatar, i cili në këtë rast është secili qytetar i cili shfrytëzon transportin publik, andaj edhe vëmendja e kësaj kategorie është më e ulët dhe se vetëm shtimi i termit “Reisen”, assesi nuk e shmangë mundësinë e konfuzionit të konsumatorit.

Sa i përket ngjashmërive në aspektin fonetik, paditësi ka theksuar se në rastin konkret ka ngjashmëri identike në pjesën kryesore të markës, e që është fjala “Shpejtimi”, e po ashtu edhe në dukje dhe kuptim të markës, ndërsa në aspektin konceptuar, shtimi i termit “Reisen” edhe më shumë i shkakton konfuzion konsumatorit, pasi që konsumatori është i mësuar që një term të tillë ta dëgjoj dhe ta sheh në shumë agjencione turistike dhe kompani transportuese dhe nuk ka asnjë mundësi të vetme që të kuptoj se në rastin konkret ka të bëjë me dy kompani të ndryshme.

I ka propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

I padituri në përgjigje në padi, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare përmes të autorizuarve të tij, e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, duke shtuar që sipas dispozitave të LMT-së, për vlerësimin e ngjashmërisë tek markat tregtare duhet krahasuar të gjitha elementet e markës tregtare siç janë: dukja, shqiptimi dhe kuptimi i markës tregtare, duke u bërë vlerësimi i përgjithshëm i të gjitha ngjashmërive dhe dallimeve të markës tregtare si tërësi.

Në rastin konkret i padituri ka theksuar që edhe pse kemi të bëjmë me aktivitet të ngjashëm biznesor, marka tregtare e regjistruar e paditësit dhe marka e përdorur nga i padituri kanë dallime në pamje, në kuptim si dhe në konceptin e tërësishëm të paraqitjes së shenjave në dizajnin grafik. Sa i përket pretendimit të emrit, ka theksuar që emri i kompanisë së paditësit përbehet nga fjalët “Shpejtimit SH.P.K.”, ndërsa emri i të paditurit përbehet nga fjalët “Shpejtimi Reisen”, ku vërehet dallueshmëria që në shikim të parë dhe kuptohet që bëhet fjalë për kompani tjetër. Po ashtu edhe tek ngjyrat ka theksuar që ekziston dallueshmëri e madhe, duke marr parasysh që “Shpejtimi Reisen”, ka edhe figurën para emrit të tij, dhe se i padituri regjistrimin në ARBK e ka bërë konform rregullativës ligjore.

Më tutje ka theksuar që ka dallim esencial në regjistrimin e emrave, meqenëse dallon dukshëm emri i paditësit dhe emri i të paditurit, sepse njëri është i regjistruar pranë ARBK-së, me emrin Shpejtim Veselaj B.I., ndërsa tjetri është i regjistruar me emrin Shpejtimit SH.P.K., duke theksuar që nuk janë vetëm këto dy kompani që bartin këtë emër dhe pavarësisht faktit që paditësi ka patentuar emrin “Shpejtimi”, i njëjti dallon me emrin e të paditurit, meqenëse “Shpejtimi Reisen”, përbehet nga dy fjalë, ku ngjyrat, fonti dallojnë dukshëm, e poashtu tek emri i të paditurit dallojnë edhe shenjat me figura, të cilat paditësi nuk i ka.

I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar mirëpo nuk i ka specifikuar.

Për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në shqyrtimin kryesor ka bërë administrimin e provave si në vijim : Certifikata për markën tregtare, e datës 06.03.2020 nr.: KS/2020/1223; të dhënat e biznesit për NUI:811850420; Aplikacioni për regjistrimin e markës tregtare nr. KS/M/2022/000460, e datës 22.03.2022; Ftesa për paraqitjen e vërejtjeve për kundërshtim, e datës 27.03.2023 nr.: KS/2023/2912; Vërejtja në kundërshtim, e datës 29.05.2023 me nr.: KS/2023-003495; Certifikata e regjistrimit të markës tregtare të BE-së, e datës 06.10.2023 me nr.018831164 në gjuhën angleze dhe e përkthyer në gjuhën shqipe; Certifikatë regjistrim marke, e datës 19.09.2023 me nr regjistrimi 24149 lëshuar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë – Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, Drejtoria e Ekzaminimit e Republikës së Shqipërisë.

Deklarimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Sipas Certifikatës për markën tregtare nr.: KS/2020/1223 të datës 06.03.2020 dhe Vendimin për regjistrimin e markës tregtare në regjistrin e markave tregtare me nr. 26217, nr. aplikimi KS/M/2019/657 të datës 23.05.2019, vërtetohet se paditësi ka të regjistruar pranë Agjencisë së Pronësisë Industriale, markën tregtare fjalë “Shpejtimi”, dhe se i njëjti është pronar dhe bartës i së drejtës së markës tregtare verbale për produktet dhe shërbimet nga klasa 35 dhe 39 të Klasifikimit të Nicës.

Nga të dhënat e biznesit për NUI:811850420, rezulton se i padituri Shpejtim Veselaj B.I., ka regjistruar emrin tregtar Shpejtimi Reisen me datën 09.08.2021.

Nga Aplikacioni për regjistrimin e markës tregtare nr. KS/M/2022/000460 të datës 22.03.2022, ftesa për paraqitjen e vërejtjeve për kundërshtim të datës 27.03.2023 nr.: KS/2023/2912 dhe vërejtjes në kundërshtim të datës 29.05.2023 me nr.: KS/2023-003495 rezulton se i padituri ka aplikuar për regjistrimin e shenjës “ShpejtimiReisen”, ndaj të cilës është paraqitur kundërshtim nga ana e paditësit dhe përgjigje në kundërshtim nga ana e të paditurit.

Sipas certifikatës së regjistrimit të markës tregtare të BE-së, të datës 06.10.2023 me nr. 018831164 në gjuhën angleze dhe e përkthyer në gjuhën shqipe, rezulton se marka tregtare verbale e paditësit “Shpejtimi”, është regjistruar me datën 06.10.2023 sipas numrit të regjistrimit 018831164 në regjistrin e markave tregtare të Bashkimit Evropian.

Nga certifikata regjistrim marke e datës 19.09.2023 me nr. regjistrimi 24149 të lëshuar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë – Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale, Drejtoria e Ekzaminimit e Republikës së Shqipërisë, rezulton se marka tregtare verbale e paditësit “Shpejtimi”, është regjistruar në Republikën e Shqipërisë dhe e njëjta gëzon mbrojtje për periudhën dhjetë vjeçare duke filluar nga data 19.09.2023.

Gjykata për të vlerësuar nëse janë të bazuara pretendimet e paditësit për shkeljen e markës tregtare nga ana e të paditurit i është referuar Nenit 9 të Ligjit Nr. 08/L-075 Për Markat Tregtare - (tutje LMT), i cili përcakton shkeljet e markës tregtare.

Sipas kësaj dispozite, shkelje të markës tregtare përbën çdo shenjë që është identike ose e ngjashme me markën tregtare apo që për shkak të njëjlojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave për të cilat përdoret shenja, me mallrat që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion te publiku, ku përfshihet edhe mundësia e asocimit së shenjës së përdorur me markën tregtare.

Për vërtetimin e shkeljes së markës tregtare, duhet të merren parasysh kriteret themelore për vlerësimin e ngjashmërisë në mes të markave tregtare si: shkalla e ngjashmërisë vizuale (në pamje), shkalla e ngjashmërisë aurale (në dëgjim), si dhe shkalla e ngjashmërisë konceptuale.

Sipas nenit 9 par.2 nën par 2.2 të LMT-së, përcaktohet se: *“2.Pronari i markës tregtare të regjistruar ka të drejtë të ndalojë të gjitha palët e treta që nuk kanë pëlqimin e tij që ta përdorin atë gjatë afarizmit tregtarë, lidhur me mallra apo shërbime, çfarëdo shenje që: ... 2.2. është identike ose e ngjashme me markën apo që, për shkak të njëjlojshmërisë apo ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve, për të cilat përdoret shenja, me mallrat apo shërbimet, që mbulohen nga marka e regjistruar, mund të shkaktojnë konfuzion të publiku lidhur me markën tregtare;...”*

Në rastin konkret, gjykata duke iu referuar kriterëve themelore për vlerësimin e ngjashmërisë së shenjave në fjalë, pasi ka vlerësuar shkallën e ngjashmërisë vizuale (në pamje), shkallën e ngjashmërisë aurale (në dëgjim), shkallën e ngjashmërisë konceptuale, llojin e markave tregtare, nga provat e administruara gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Sipas nenit 9 të LMT-së, kërkohet ekzistimi i identitetit midis markave/shenjave në diskutim dhe mallrave apo shërbimeve në fjalë. Kjo dispozitë nuk imponon provimin e mundësisë së shkaktimit të konfuzionit tek konsumatori relevant, midis markës së mëhershme dhe markës për të cilën pretendohet se shkel markën e mëparshme. Se kur dy marka mund të konsiderohen identike dallohet varësisht nëse kemi të bëjmë me markat fjalë apo marka figurative ose të përziëra. Nga gjendja faktike e vërtetuar, gjykata vlerëson se paditësi ka të mbrojtur markën tregtare fjalë dhe se ndërmjet markës tregtare verbale të paditësit dhe shenjave të përdorura nga i padituri ekzistojnë dallime të mëdha, pasi që marka e paditësit përbëhet vetëm nga fjala “SHPEJTIMI”, ndërsa i padituri përdor shenjen “ShpejtimiREISEN”.

Duke marrë parasysh faktin se paditësi e ka të regjistruar markën e tij tregtare “Shpejtimi”, si markë verbale, ndërsa markat tregtare verbale (Markat Fjalë) gëzojnë mbrojtje juridike të kufizuar, gjykata vlerëson se tek këto marka tregtare paditësi mund ta kontestojë përdorimin e kësaj shenje, vetëm në rastet e të ashtuquajturit “identiteti i dyfishtë” midis markës së mëhershme të regjistruar dhe markës së shkelësit.

Gjykata vlerëson se mbrojtja e markës fjalë si në rastin konkret, mund të kërkohet vetëm nëse të njëjtat janë identike, përkatësisht të dy markat janë marka fjalë dhe kanë saktësisht të njëjtën varg të shkronjave apo numrave. Mirëpo nëse njëra markë është markë fjalë, ndërsa tjetra është markë figurative apo e stilizuar, atëherë nuk mund të ekzistoj identiteti i markave, meqenëse një markë fjalë dhe një markë figurative nuk mund të konsiderohen identike.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat, Gjykata vlerëson se pretendimi i paditësit për shkeljen e markës tregtare nga i padituri është i pa bazuar, meqenëse në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me lloje të njëjta të markave tregtare. Duke marrë parasysh se qëllimi kryesor i markës tregtare është që të shërbejë si identifikues i burimit të produktit dhe se marka duhet të ketë veçori dalluese, si dhe duke u nisur nga kriteri i rëndësishëm i vlerësimit të shkeljes së markës tregtare, të ashtuquajturit “spektri i dallueshmërisë”, gjykata vlerëson se shenja e përdorur nga i padituri ka dallime nga marka fjalë e regjistruar e paditësit, me çka rezulton se marka fjalë e paditësit nuk është cenuar nga i padituri, dhe si rrjedhojë gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit, për vërtetimin e shkeljes së markës tregtare nga ana e të paditurës, nuk ka mbështetje ligjore.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 dhe nenit 463 par.2 të LPK-së. Gjykata ka caktuar që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta procedurale, meqenëse pala e paditur nuk i ka specifikuar shpenzimet e procedurës.

Nga arsyet e cekura më lart, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr.61/23, datë 23.04.2024.

Gjyqtari  
Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.